
		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektor:</i>

# KOSTT

## Raport për tremujorin e tretë 2010


(01.07.2010-30.09.2010)

	<b>Përgatiti</b>	<b>Kontrolloi</b>	<b>Aprovoi</b>
Emri Mbiemri	Shpresa Kursani	Fadil Ismajli KSHE	Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	<i>Tetor 2010</i>	15.11.2010	25.11.2010

		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 2 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

**Tetor 2010**  
**Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT**  
**Periudha Korrik- Shtator 2010**

1	<b>Titulli i Dokumentit</b>	Raport për tremujorin Korrik - Shtator 2010
2	<b>Dërguesi i dokumentit</b>	Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv
3	<b>Përmbajtja e Raportit</b>	<p><b>Kapitulli 1:</b> Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë tremujorit të tretë 2010</p> <p><b>Kapitulli 2:</b> Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare</p> <p>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Teknik të Performancës – Operatori i Sistemit dhe Operatori i Transmisionit</p> <p>2.2. Raport i Operatorit të Tregut</p> <p>2.3. Projektet Aktive në KOSTT dhe statusi</p> <p>2.4. Çështjet Ligjore dhe Rregullative</p> <p>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare</p> <p>2.5.1 Pasqyrat financiare (Balanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes)</p> <p>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p><b>Kapitulli 3 :</b> Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p><b>Kapitulli 4:</b> Transakcionet e konsiderueshme në tremujorit të tretë 2010</p> <p><b>Kapitulli 5:</b> Të arriturat, dështimet dhe sygjerimet</p> <p><b>Shtojcë 1:</b> Aktivitetet e posaçme</p>
4	<b>Data e Raportimit</b>	Nëntor 2010

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

## Hyrje


Raporti i tremujorit Korrik – Shtator 2010 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar (“tremujori përkatës”) i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të tretë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të tretë, të arriturat/dështimet e departamenteve gjatë tremujorit përkatës, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet aktivitetet e posaçme të KOSTT gjatë periudhës raportuese.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nenin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

## 1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të tretë 2010

### 1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit. Përbëhet nga afarizmi themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet si:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, zhvillimor, komercial, rregullativ, ligjor, si dhe administrativ, që zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:


- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat dhe
- Burimet Njerëzore

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Planifikim Strategjik dhe Buxhet
- Zyra për Prokurim
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mbrojtje nga Zjarri

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 7 (shtatë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT gjithashtu janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, Sekretarit të Kompanisë njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizim aktual i KOSTT-it është paraqitë në Makro Strukturën Organizative e cila ka pësua një ndryshim në periudhën e fundit të këtij viti. Ndryshimet përbëjnë kryesisht

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

kërkesat e bazuara në Statutin e KOSTT-it dhe Ligjin për Ndërmarrje Publike, ku përfshihen kërkesat për emërtime përkatëse të Zyrtarëve në KOSTT.

## 1.2. Numri i Punëtorëve

Më 01 Korrik 2010, numri i të punësuarve në KOSTT ka qenë 216, ndërsa më 30 Shtator 2010 numri i të punësuarve ka rënë në 214.

Arsye e ndryshimit të numrit të punëtorëve është:

- 1 (një) punëtor (Inxhinier Specialist për EMS në Departamentin e Operimit të Sistemit) i është shkëputur marrëdhënia e punës me datën 7 korrik 2010 me kërkesën e tij
- 1 (një) punëtor (Teknik në Departamentin e Operimit të Transmisionit) ka ndërruar jetë më 14 gusht 2010.

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it, ku poashtu nuk ka pasë ndryshime gjatë tremujorit të tretë.




ver. 1.0

DT-PB-002

faqe 6 nga 47

Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave      Sektori:



	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## 2. Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare


### 2.1. Raport nga Operatori i Sistemit dhe i Transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës

#### 2.1.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për korrik-shtator 2010


Muajt	korrik			gusht			shtator			Korrik-Shtator 2010		
	E planifikuar	E realizuar	%	E planifikuar	E realizuar	%	E planifikuar	E realizuar	%	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
MWh												
TC Kosova A	119 784	164 561	<b>137.38</b>	119 784	157 461	<b>131.45</b>	115 920	86 671	<b>74.77</b>	<b>355 488</b>	<b>408 693</b>	<b>114.97</b>
TC Kosova B	76 704	88 982	<b>116.01</b>	196 860	196 471	<b>99.80</b>	324 360	336 803	<b>103.84</b>	<b>597 924</b>	<b>622 256</b>	<b>104.07</b>
Sh.A.Kosova Thengjilli	0	0		0	0		0	0		<b>0</b>	<b>0</b>	
HC Ujmani	2 000	2 952	<b>147.60</b>	2 000	3 601	<b>180.07</b>	5 000	4 445	<b>88.90</b>	<b>9 000</b>	<b>10 998</b>	<b>122.20</b>
HC Lumbardhi	1 722	2 164	<b>125.67</b>	961	972	<b>101.19</b>	695	761	<b>109.54</b>	<b>3 378</b>	<b>3 898</b>	<b>115.39</b>
<b>Prodhimi gjithsejt</b>	<b>198 488</b>	<b>256 495</b>	<b>129.22</b>	<b>318 644</b>	<b>357 533</b>	<b>112.20</b>	<b>445 280</b>	<b>427 919</b>	<b>96.10</b>	<b>962 412</b>	<b>1 041 947</b>	<b>108.26</b>
Devijimi		- 3 500			6 390			- 6 583		<b>0</b>	- 3 693	
Eksporti		<b>10 158</b>			<b>18 754</b>			<b>65 490</b>		<b>0</b>	<b>94 402</b>	
Importi	<b>151 900</b>	<b>120 910</b>	<b>79.60</b>	<b>64 000</b>	<b>58 995</b>	<b>92.18</b>	<b>0</b>	<b>6 620</b>		<b>215 900</b>	<b>186 525</b>	<b>86.39</b>
<b>Energjia në disponim</b>	<b>350 388</b>	<b>370 747</b>	<b>105.81</b>	<b>382 644</b>	<b>391 384</b>	<b>102.28</b>	<b>445 280</b>	<b>375 632</b>	<b>84.36</b>	<b>1 178 312</b>	<b>1 137 763</b>	<b>96.56</b>
Distribucioni	270 486	293 688	<b>108.58</b>	267 771	284 113	<b>106.10</b>	275 298	283 636	<b>103.03</b>	<b>813 555</b>	<b>861 436</b>	<b>105.89</b>
Ferronikeli	54 312	42 750	<b>78.71</b>	54 312	56 190	<b>103.46</b>	52 560	46 672	<b>88.80</b>	<b>161 184</b>	<b>145 612</b>	<b>90.34</b>
Trepça	2 400	1 712	<b>71.33</b>	2 300	1 571	<b>68.29</b>	2 300	1 574	<b>68.42</b>	<b>7 000</b>	<b>4 856</b>	<b>69.37</b>
Sharri	6 500	4 646	<b>71.48</b>	6 500	5 932	<b>91.26</b>	6 500	5 836	<b>89.79</b>	<b>19 500</b>	<b>16 414</b>	<b>84.18</b>
Shpenzimet e gjen.nga transm.dhe Kosova thengj.	11 715	15 144	<b>129.27</b>	11 715	32 124	<b>274.21</b>	10 715	27 970	<b>261.04</b>	<b>34 145</b>	<b>75 238</b>	<b>220.35</b>
<b>Kërkesa neto</b>	<b>345 413</b>	<b>357 940</b>	<b>103.63</b>	<b>342 598</b>	<b>379 929</b>	<b>110.90</b>	<b>347 373</b>	<b>365 687</b>	<b>105.27</b>	<b>1 035 384</b>	<b>1 103 556</b>	<b>106.58</b>
Humbjet në transmission	11 563	10 695	<b>92.49</b>	12 627	9 535	<b>75.51</b>	14 694	8 800	<b>59.89</b>	<b>38 884</b>	<b>29 030</b>	<b>74.66</b>
<b>Kërkesa gjithsej</b>	<b>356 976</b>	<b>368 635</b>	<b>103.27</b>	<b>355 225</b>	<b>389 464</b>	<b>109.64</b>	<b>362 067</b>	<b>374 487</b>	<b>103.43</b>	<b>1 074 268</b>	<b>1 132 586</b>	<b>105.43</b>

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:

### Bilanci i planifikuar Korrik-Shtator 2010



### Bilanci i realizuar Korrik-Shtator 2010



Humbjet në transmision gjatë tremujorit Korrik-Shtator 2010 kanë qenë më të mëdha për **1,51%** krahasuar me tremujorin Korrik-Shtator 2009, edhe pse në muajt Gusht dhe Shtator 2010, humbjet kanë qenë më të vogla. Kjo mund të sqarohet si çështje e stabilizimit të leximeve si rezultat i aktivizimit të projektit të ri të njehsorëve. Përqindja e humbjeve si në tabelë është llogaritur ndaj energjisë së tërë që hyn në transmision, e që është më e vogël gjatë kësaj periudhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009.





ver. 1.0

DT-PB-002

faqe 9 nga 47

Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave

Sektor:

## 2.1.2. Shkëmbimet fizike nëpër largpërçues dhe importi - eksporti i kontraktuar

		2009				2010				2010/2009	
		Korrik	Gusht	Shtator	Korrik-Shtator 2009	Korrik	Gusht	Shtator	Korrik-Shtator 2010		
Transmisori (KOSTT sht)	<b>MWh</b>										
	<b>Linjat 400 kV</b>										
	Maqedonia	Dërgim	294.869	161.201	79.178	535.248	163.032	222.012	160.521	545.564	101,93
		Marrje	0	4	3.118	3.122	128	0	82	210	6,73
	Serbia	Dërgim	0	0	0	0	0	0	0	0	
		Marrje	341.694	239.721	188.547	769.961	335.096	322.780	248.706	906.582	117,74
	Mali Zi	Dërgim	26.944	56.421	105.388	188.753	60.639	50.500	84.791	195.930	103,80
		Marrje	10.122	1.328	258	11.708	8.316	2.870	1.027	12.213	104,31
	<b>Total</b>	<b>Dërgim (+)</b>	<b>321.813</b>	<b>217.622</b>	<b>184.566</b>	<b>724.001</b>	<b>223.670</b>	<b>272.512</b>	<b>245.312</b>	<b>741.494</b>	<b>102,42</b>
		<b>Marrje (-)</b>	<b>351.816</b>	<b>241.052</b>	<b>191.923</b>	<b>784.791</b>	<b>343.540</b>	<b>325.650</b>	<b>249.815</b>	<b>919.005</b>	<b>117,10</b>
	<b>Balanci</b>	<b>(D) - (M)</b>	<b>-30.003</b>	<b>-23.430</b>	<b>-7.357</b>	<b>-60.790</b>	<b>-119.870</b>	<b>-53.138</b>	<b>-4.503</b>	<b>-177.511</b>	<b>292,01</b>
	<b>Linjat 220 kV</b>										
	Serbia	Dërgim	17.443	8.339	5.708	31.490	3.678	1.758	6.770	12.205	38,76
		Marrje	1.081	4.159	2.529	7.769	12.397	14.079	5.098	31.574	406,42
	Shqipëria	Dërgim	15.107	21.903	22.840	59.850	34.736	40.957	61.965	137.658	230,00
		Marrje	5.740	3.712	8.750	18.202	984	727	34	1.745	9,59
	<b>Total</b>	<b>Dërgim (+)</b>	<b>32.550</b>	<b>30.242</b>	<b>28.548</b>	<b>91.340</b>	<b>38.413</b>	<b>42.715</b>	<b>68.735</b>	<b>149.863</b>	<b>164,07</b>
		<b>Marrje (-)</b>	<b>6.821</b>	<b>7.871</b>	<b>11.279</b>	<b>25.970</b>	<b>13.381</b>	<b>14.806</b>	<b>5.132</b>	<b>33.319</b>	<b>128,30</b>
	<b>Balanci</b>	<b>(D) - (M)</b>	<b>25.729</b>	<b>22.371</b>	<b>17.270</b>	<b>65.370</b>	<b>25.032</b>	<b>27.908</b>	<b>63.603</b>	<b>116.544</b>	<b>178,28</b>
	<b>Linjat 110 kV</b>										
	Bujanovci	Dërgim	719	778	762	2.259	49	939	650	1.638	72,52
		Marrje	908	2.693	8	3.609	15.465	2.558	2	18.025	499,38
	Novi Pazar	Dërgim	127	0	1	128	1.518	1.933	1.708	5.159	4.046,46
	Marrje	3.899	8.216	1.514	13.628	3.404	7.016	8.026	18.446	135,35	
<b>Total</b>	<b>Dërgim (+)</b>	<b>846</b>	<b>778</b>	<b>763</b>	<b>2.386</b>	<b>1.567</b>	<b>2.872</b>	<b>2.358</b>	<b>6.798</b>	<b>284,85</b>	
	<b>Marrje (-)</b>	<b>4.806</b>	<b>10.909</b>	<b>1.523</b>	<b>17.238</b>	<b>18.869</b>	<b>9.574</b>	<b>8.028</b>	<b>36.471</b>	<b>211,57</b>	
<b>Balanci</b>	<b>(D) - (M)</b>	<b>-3.961</b>	<b>-10.131</b>	<b>-760</b>	<b>-14.852</b>	<b>-17.303</b>	<b>-6.702</b>	<b>-5.669</b>	<b>-29.674</b>	<b>199,80</b>	
Gjithsejt rrjedhat fizike nëpër LP Dërgim (+)	Dërgim (+)	355.209	248.641	213.877	817.728	263.650	318.099	316.406	898.155	109,84	
Gjithsejt rrjedhat fizike nëpër LP Marrje (-)	Marrje (-)	363.443	259.832	204.724	827.999	375.791	350.030	262.975	988.796	119,42	
<b>Gjithsejt Balanci i net shkëmbimeve (fizike)</b>	<b>1=(D) - (M)</b>	<b>-8.234</b>	<b>-11.191</b>	<b>9.153</b>	<b>-10.272</b>	<b>-112.140</b>	<b>-31.931</b>	<b>53.431</b>	<b>-90.641</b>	<b>882,43</b>	
KEK sht	Dërgim (+) (Shkëmbimet sipas programit)	(D)	16.592	18.872	22.302	57.766	10.158	18.754	34.137	63.049	109,15
	Marrje (-) (Shkëmbimet sipas programit)	(M)	2.400	0	0	2.400	0	0	0	0	0,00
	<b>Balance KEK (Dërgim - Marrje)</b>	<b>(D) - (M)</b>	<b>14.192</b>	<b>18.872</b>	<b>22.302</b>	<b>55.366</b>	<b>10.158</b>	<b>18.754</b>	<b>34.137</b>	<b>63.049</b>	<b>113,88</b>
	Export (+) (KEK Kontrate)	(E)	9.555	2.400	16.900	28.855	0	0	31.353	31.353	108,66
	Import (-) (KEK Kontrate)	(I)	32.095	37.884	30.610	100.589	120.910	58.995	6.620	186.525	185,43
	<b>Balance KEK (Export - Import)</b>	<b>(E) - (I)</b>	<b>-22.540</b>	<b>-35.484</b>	<b>-13.710</b>	<b>-71.734</b>	<b>-120.910</b>	<b>-58.995</b>	<b>24.733</b>	<b>-155.172</b>	<b>216,32</b>
	<b>Gjithsejt dhënje (sipas programit)</b>	<b>(D)+(E)</b>	<b>26.147</b>	<b>21.272</b>	<b>39.202</b>	<b>86.621</b>	<b>10.158</b>	<b>18.754</b>	<b>65.490</b>	<b>94.402</b>	<b>108,98</b>
	<b>Gjithsejt marrje (sipas programit)</b>	<b>(M)+(I)</b>	<b>34.495</b>	<b>37.884</b>	<b>30.610</b>	<b>102.989</b>	<b>120.910</b>	<b>58.995</b>	<b>6.620</b>	<b>186.525</b>	<b>181,11</b>
	Tranziti		329.292	223.828	175.352	728.472	254.323	296.238	250.340	800.901	109,94
	Tranziti në rrjetin horizontal		327.758	220.605	174.119	722.482	251.389	291.066	243.847	786.302	108,83
	<b>Total Net Balanci i shkëmbimeve (sipas programit)</b>		<b>-8.348</b>	<b>-16.612</b>	<b>8.592</b>	<b>-16.368</b>	<b>-110.752</b>	<b>-40.241</b>	<b>58.870</b>	<b>-92.123</b>	<b>562,82</b>

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Spektori: Planifikimi afatmesëm</i>

### 2.1.3. Indikatorët Kyç të Performancës - Operatori i Sistemit

Nr	Indikator	2009				2010				2010/2009(%)	
		Korrik	Gusht	Shtator	Korrik-Shtator	Korrik	Gusht	Shtator	Korrik-Shtator		
T1	Energjia e transmetuar (GWh)	707,06	618,2	585,1163	<b>1910,38</b>	632,28	707,56	690,89	<b>2030,74</b>	<b>106,30</b>	
T2	Piku koincident (MW)	me tranzit	652	700	775	<b>775</b>	679	729	792	<b>792</b>	<b>102,19</b>
		pa tranzit									
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	380 kV				<b>181,356</b>				<b>181,815</b>	<b>100,25</b>
		220 kV				<b>231,882</b>				<b>231,882</b>	<b>100,00</b>
		110 kV				<b>646,029</b>				<b>672,1085</b>	<b>104,04</b>
T4	MVA-km	380 kV				<b>201029</b>				<b>239450</b>	<b>119,11</b>
		220 kV				<b>77506</b>				<b>77506</b>	<b>100,00</b>
		110 kV				<b>65845</b>				<b>78279</b>	<b>118,88</b>
T5	Kapaciteti i transformatorëve	380-220/110 kV				<b>1200</b>				<b>1500</b>	<b>125,00</b>
		220-110 kV				<b>900</b>				<b>1050</b>	<b>116,67</b>
T9	Koha mesatare e rënjes (AIT minuta/vit)	26,5	318,08	98,93	<b>443,51</b>	92,69	9,27	0,93	<b>102,89</b>	<b>23,20</b>	
T10	Numri i ankesave për tension	2	5	0	<b>7</b>		1	1	<b>2</b>	<b>28,57</b>	
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	2	5	0	<b>7</b>		1	1	<b>2</b>	<b>28,57</b>
		Më pak se një muaj									
		Më shumë se një muaj									
T12	Numri i ankesave për matje				<b>0</b>				<b>0,00</b>		
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë				<b>0</b>				<b>0,00</b>	
		Më pak se një muaj									
		Më shumë se një muaj									
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/hour)	Import	10,37	8,39	11,72	<b>10,16</b>	14,59	15,09	23,65	<b>17,78</b>	<b>174,97</b>
		Ekspert	8,01	14,62	12,03	<b>11,55</b>	9,89	23,68	14,51	<b>16,03</b>	<b>138,72</b>
T15	Humbjet në transmision (GWh)	8,72	10,06	9,82	<b>28,60</b>	10,695	9,535	8,800	<b>29,03</b>	<b>101,51</b>	

$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$   
 TE-Transmitted energy

ENS-Energy not supply  
 AIT- Average interruption time

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

<b>T1</b> Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 6,30 % është transmetuar energji më shumë gjatë periudhës Korrik-Shtator 2010 se sa Korrik-Shtator 2009.
<b>T2</b> Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 2,19 % është piku më i lartë në periudhën Korrik-Shtator 2010 se sa Korrik-Shtator 2009.
<b>T3</b> Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit, e që dukshëm është në rritje.
<b>T4</b> Caku është si në T3
<b>T5</b> Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri. Bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. Kapaciteti i transformatorëve për periudhën Korrik-Shtator 2010 është më i madh krahasuar me atë gjatë vitit 2009.
<b>T9</b> AIT (Koha mesatare e rënies) nga 443,51 minuta gjatë tre muajve Korrik-Shtator 2009, është zvogëluar në 102,89 minuta për periudhën e njëjtë 2010, që shkon në favor të KOSTT-it
<b>T10</b> Caku për ankesa të tensionit duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtër.
<b>T11</b> Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë i zgjidhur në afat sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.
<b>T12</b> Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak, respektivisht për periudhën për të cilën raportohet.
<b>T13</b> Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë i zgjidhur në afat sa më të shkurtër që të jetë e mundur.
<b>T14</b> Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla, por për periudhën Korrik-Shtator 2010 vlera mesatare e devijimeve ka qenë më e madhe se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
<b>T15</b> Humbjet kanë qenë për 1,51% më të mëdha në periudhën Korrik-Shtator 2010 se sa në periudhën Korrik-Shtator 2009.

Vërejtje: Indikatorët T6, T7, T8 janë ende të paaplikueshëm


	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

#### 2.1.4. Indikatorët Kyç të Performancës - Operatori i Transmisionit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	2009	2010	Krahasimi	Caku
		kV	Korrik-Shtator	Korrik-Shtator	Q3-2010/ Q3-2009 (%)	< = 1
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.77	0.77	100	
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	0.00	0	Është e ndikuar nga linja 126/4 e cila kyçet në NS Vallaqi. Niveli dhe forma e sigurisë në pjesën veriore të vendit kanë ndikuar në vonesën e qasjes, identifikimit dhe evitimit të prishjes.
		220	0.00	0.00	0	
		110	4.10	5.30	129.2683	
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.10	0.00	0	
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1
		220/110	0.00	0.00	0	
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1
		220/110	0.00	0.00	0	
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes	400/220(110)	0.00	0.00	0	< = 1

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

	së transformatorit (minuta)	220/110	0.00	0.00	0	
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	NS Vitia. Problemet ne mekanizmin e ndërprerësit
		220	3.33	0.00	0	
		110	1.20	1.84	153.3333	
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0.00	0	NS Vitia. Në pamundësi për aftësimin e mekanizmit ekzistues te ndërprerësit është bërë ndërrimi komplet i tij.
		220	1.80	0.00	0	
		110	1.00	1.52	152	
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	2.77	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	1.30	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0	< = 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	

		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 14 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

## 2.2. Raport nga Operatori i Tregut

### Raporti i Madhësisë së Tregut Korrik-Shtator 2010


*Ky raport përmbanë informata rreth madhësisë së tregut, pjesës së rregulluar dhe të pa-rregulluar, si dhe çmimin e arritur, si mesatare e ponderuar me energjinë, në tregun me shumicë*

Pjesa më e madhe e tregut të Kosovës është e rregulluar, prandaj madhësia e tregut, që i referohet segmentit të pa-rregulluar paraqitet si raport i energjisë se konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar<sup>1</sup> (kualifikuar) ndaj konsumit të përgjithshëm në Kosovë që përfshinë energjinë e përgjithshme të dalur nga transmissioni dhe energjinë e hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.


Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në tremujorin Korrik-Shtator '10 ishte mesatarisht rreth 80.2% të konsumit të përgjithshëm bruto (pa humbjet në transmision). Nëse fusim komponenten e reduktimeve atëherë kjo përqindje është 78.58%.

Figura 2 paraqet figurativisht madhësinë e tregut të rregulluar (tarifor) në raport me tregun e parregulluar. Konsumi i KEK, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor është i paraqitur gjithashtu në figurë.

#### Informata nga tregu i Kosovës





<sup>1</sup> Konsumatorë të kualifikuar janë: "Birra Peja", "Sharr Cem" dhe "Feronikeli". Nga këta, vetëm "Feronikeli" ka kontratë bilaterale me KEK-un, ndërsa dy të tjerat, kanë çmim të rregulluar.



Operatori i Tregut ka kalkuluar edhe çmimin mesatar të sistemit për secilin muaj të 2009 duke e krahasuar edhe me çmimin e këtij tremujori të 2010. Çmimi i prodhimit në Kosovë është marrë nga modeli tarifor i vitit 2010, përderisa çmimi dhe sasia e importit është ajo që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e tij. Meqenëse në këtë tremujor importi dhe çmimi i tij ishte i ulët, çmimi i sistemit – mesatar në tremujor ishte 24.15 €/MWh. Figura më poshtë paraqet çmimin mesatar të sistemit nëpër muaj nga Janari 2009 deri në Shtator 2010.

### Çmimi mesatar i sistemit



		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 16 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

## 2.1. Projektet aktive në KOSTT dhe statusi

Nr.	Emërtimi i Projektit	Vlera e kontraktuar	Buxheti i siguruar 2010 nga BK dhe donatorët	Realizimi 2009+Q1+Q2 (BK)	Realizimi nëpër kuartale 2010			Total Q3	Total (2009+Q1+Q2+Q3)
					Korrik	Gusht	Shtator		
1	Renovimi i NS 220/110 kV - Kosova A dhe Shërbimet Konsulente	10,334,073.00	450,000.00	8,914,435.00	0.00	0.00	0.00	0.00	8,914,435.00
2	Paket Projekti NS Peja 3 (LOT1+LOT2) dhe Shërbimet Konsulente	23,343,233.00	2,000,000.00	9,211,635.00	0.00	0.00	0.00	0.00	9,211,635.00
3	SCADA/EMS & Telekom (LOT1+LOT2) dhe Shërbimet Konsulente	17,981,680.00	6,207,911.00	11,956,619.89	0.00	2,117,429.00	0.00	2,117,429.00	14,074,048.89
4	Njehsorët e KOSTT-it- BKK	2,071,783.00	0.00	2,087,955.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,087,955.00
5	Paket Projekti NS Ferizaj 2 (LOT1 +LOT2+LOT3)	-	700,000.00	4,373,353.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4,373,353.00
6	Furnizimi dhe Instalimi i TR1 në NS Kosova A	2,844,980.00	0.00	2,732,170.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,732,170.00
7	Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i TR 150MVA dhe Pajisjeve të Tensionit të lartë në NS 220/110 kV Prishtina 4 LOT1 dhe LOT2	2,989,356.37	3,500,000.00	2,330,434.36	0.00	0.00	0.00	0.00	2,330,434.36
8	Linja 400 kV Kosovë-Shqipëri, shërbimet e konsulencës	366,639.00	500,000.00	366,639.00					366,639.00
<b>TOTAL</b>		<b>59,931,744.37</b>	<b>13,357,911.00</b>	<b>41,973,241.25</b>	<b>0.00</b>	<b>2,117,429.00</b>	<b>0.00</b>	<b>2,117,429.00</b>	<b>44,090,670.25</b>

Projektet në tabelën e mësipërme kanë kohëzgjatjet edhe më shumë se 2 vjet dhe sa i përket realizimit financiar të disave prej tyre, mund të përfshijnë edhe vitet 2008, 2009 dhe 2010.




	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

### Realizimi i Projekteve Kapitale

	<b><u>Buxheti i nënshkruar</u></b>	Janar/Mars 2010		Prill/Qershor 2010		Korrik/ Shtator 2010		Tetor /Dhjetor 2010		Totali		Mbetja	buxheti i pa shpenzuar
		Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet	Realizimi	Hyrjet Janar-Dhjetor	Realizimi		
<b>T1-KOSTT</b> <b>Rehabilitimi i NS</b> <b>Kosova A dhe</b> <b>Shërbime</b> <b>Konsulentësh për</b> <b>NS Kosova A</b>	414,901	0	<b>0</b>	31,794	31,794					31,794	<b>31,794</b>	0	383,107
<b>T2-KOSTT</b> <b>SCADA/EMS</b> <b>Telekomi dhe</b> <b>Shërbime</b> <b>Konsulentësh për</b> <b>SCADA/EMS &amp;</b> <b>Telekomi</b>	5,723,706	0	<b>0</b>	1,008,972	1,008,971	2,117,429	2,117,429			3,126,401	<b>3,126,401</b>	0	2,597,305
<b>Paket Projekti Peja 3</b> <b>Pjesa e ndërtimit të</b> <b>LP dhe S Skenderaj</b> <b>dhe LP 110kV për NS</b> <b>Klinë</b>	1,860,000	0	<b>44,690.00</b>	1,860,000	1,502,320	0				1,860,000	<b>1,502,320</b>	357,680	357,680
<b>Paket Projekti</b> <b>TS 400/110kV-</b> <b>Ferzaj 2</b>	629,405	0	<b>0</b>	0	0					0	0	0	629,405
	8,628,012		<b>44,690</b>	2,900,766	2,543,085					5,018,196	4,660,515	357,681	3,967,497

**Vërejtje:** Buxheti i nënshkruar përfshinë periudhën për tërë vitin 2010.

Kjo tabelë është paraqitur me kërkesën e Komisionit për Projekte Kapitale, përndryshe, nuk kërkohet sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

### 1. Projekti i Shërbimeve Konsulente për Rehabilitimin e NS 220/110 kV–Kosova A

- Buxheti i Siguruar: 453.020 €
- Burimi i financimit: BK
- Vlera e kontratës: 453.020 €
- Data e fillimit: 17/12/2007
- Data e kompletimit: 16/01/2010
- Kontraktues: COWI (Dk)
  
- Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:

Edhe përkundër skadimit të kontratës, konsulenca e angazhuar COWI (Dk) ka vazhduar aktivitetet e veta në menaxhimin e projektit në fjalë (pjesëmarrja në Mbledhjet e Progresit Mujor, vlerësimin e Kërkesës për ndryshim (VO) për Telekomunikacion dhe aprovimi i dizajnit për rehabilitimin e bazamenteve të portaleve në të gjitha nivelet e tensionit). Është kërkuar që të dorëzohet dokumentacioni i punës që ka bërë gjatë implementimit të projektit.

### 2. Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV – Kosova A

- Buxheti i Siguruar: 10.334.070,00 €
- Burimi i financimit: BK
- Vlera e kontratës: 9.881.052,73 €
- Data e fillimit: 17/12/2007
- Data e kompletimit: 16/12/2009
- Kontraktues: Siemens (At)
  
- Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:

Është bërë energjizimi pas përfundimit të punimeve në fazën e III dhe IV dhe Komisioni për pranim teknik intern ka dhënë vërejtjet të cilat Kontraktuesi duhet t'i përmirësoj të gjitha.

### 3. Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV

- Buxheti i Siguruar: 23.343.233,00 €
- Burimi i financimit:
- KfW: 12.350.000,00 €
- BK: 10.993.233,00 €
- Vlera e kontratës: 21.562.716,00 € (pa taksa)

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

- **Data e fillimit:** 10/06/2008
- **Data e kompletimit:** 15/03/2010
- **Kontraktues:** Siemens (At) & Umel (B&H)

- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve implementuese nga ana e KOSTT-it dhe MVV Decon (tash intec), aktivitete këto që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punëve elektrike instaluese në NS Skenderaj, punëve ndërtimore po ashtu edhe punimet në eliminimin e vërejtjeve në NS Peja3, si dhe mbajtja e Mbledhjeve Mujore, ku është raportuar nga ana e kontraktuesit progresi i arritur si dhe vështirësitë në menaxhimin e suksesshëm të projektit.

- **Menaxhimi i rreziqeve dhe pengesat:**

Projekti ka hasur në pengesa: moslejimi i ndërtimit të shtyllës nr. 1, të linjës 110 kV, që furnizon NS 110/10(20) kV – Skenderaj. Drejtori i Departamentit me stafin e tij përkatës ka zhvilluar shumë aktivitete në këtë drejtim me Autoritetet e Komunës së Skenderajt dhe pronarin e tokës, ku do të ndërtohet shtylla nr. 1, por pa sukses.

- **Rekomandimet:**

Më qëllim të zgjidhjes së çështjes pronësore juridike me pronarin e tokës ku ndërtohet shtylla nr. 1 e linjës 110 kV, rekomandohet që autoritetet përkatëse të Komunës së Skenderajt të përgatisin dhe zbatojnë procedurën e shpronësimit, pasi që ky objekt është shpallur objekt me interes të përgjithshëm dhe leja ndërtimore është lëshuar nga ata.

Në anën tjetër, rekomandohet menaxhmenti i lartë i KOSTT-it dhe Komisioni për Projekte Kapitale i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it të aranzhojnë takim të përbashkët me Kryetarin e Komunës së Skenderajt dhe pronarin e tokës, gjegjësisht pronarin e Fabrikës Vëllezërit Geci; e tëra kjo pas shumë përpjekjesh të pasuksesshme të stafit të Departamentit për M&I të Projekteve.

#### 4. Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV

- **Buxheti i Siguruar:** 700.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KE (ECLO)
- **Vlera e kontratës:** 668.500,00 €
- **Data e fillimit:** 17/12/2009
- **Data e kompletimit:** 17/10/2011
- **Kontraktues:** Ingedia (Ro)

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**

Gjatë kësaj periudhe raportuese konsulenca e angazhuar nga Komisioni Evropian (ECLO), ka zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajnit bazik për të dy LOT-at (për nënstacionin NS Ferizaj 2 si dhe për Linjat LP 400 & 110 kV).

## 5. Paket Projekti NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 & 110 kV

### *LOT 1 – Ndërtimi i Nënstacionit 400/110 kV Ferizaj 2*

- **Buxheti i Siguruar:** 15.800.000,00 €
- **Burimi i financimit:** BK
- **Vlera e kontratës:** 13.656.000,00 €
- **Data e fillimit:** 24/12/2009
- **Data e kompletimit:** 23/10/2012
- **Kontraktues:** Siemens (At)

- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**

Projekti është në fazën e përgatitjes së dizajnit bazik. Gjatë periudhës së tremujorit të tretë nuk ka pasur ndonjë në terren. Janë zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajnit bazik si dhe është mbajtur Mbledhja e Progresit Mujor\_2, ku janë diskutuar rezultatet e arritura në këtë drejtim. Po ashtu është mbajtur edhe debati publik me qytetarë lidhur me vlerësimin e ndikimit mjedisor të projektit në Asamblenë Komunale të Ferizajt, organizuar nga KOSTT dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit.

### *LOT 2 – Ndërtimi i Linjave ndërlidhëse 400 & 110 kV*

- **Buxheti i Siguruar:** 7.500.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KE (ECLO)
- **Vlera e kontratës:** 6.105.000,00 €
- **Data e fillimit:** 31/12/2009
- **Data e kompletimit:** 30/10/2011
- **Kontraktues:** Umel Dalekovodmontaza (B&H)

- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**

Projekti është në fazën e përgatitjes së dizajnit bazik. Gjatë periudhës së tremujorit të tretë nuk ka pasur ndonjë në terren. Janë zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajnit bazik si dhe është mbajtur Mbledhja e Progresit Mujor\_2, ku janë diskutuar rezultatet e arritura në këtë drejtim. Po ashtu është mbajtur edhe debati publik me qytetarë lidhur me vlerësimin e ndikimit mjedisor të projektit në Asamblenë Komunale të Ferizajt.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## 6. Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërtimit të LP 400 kV, Kosovë – Shqipëri

- **Buxheti i Siguruar:** 1.200.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KfW
- **Vlera e kontratës:** 1.154.620,00 €
- **Data e fillimit:** 24/09/2009
- **Data e kompletimit:** 23/05/2010
- **Kontraktues:** Intec (ish – decon)

### - Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur

Është përgatitur drafti final i Tender Dokumentacionit i cili është dërguar për aprovim/komentim në KOSTT dhe OST si dhe në KfW për ndonjë vërejtje. Janë mbajtur takimet e rregullta mujore të progresit ku janë diskutuar të arriturat dhe aktivitetet e nevojshme për të ardhmen. Në bazë të agjendës pritet që shpallja e tenderit për ndërtimin e linjës në fjalë të bëhet rreth mesit të Nëntorit 2010.

## 7. Shërbime Konsulentësh për Projektin e SCADA/EMS & Telekomit

- **Buxheti i Siguruar:** 891.541,00 €
- **Burimi i financimit:** BK
- **Vlera e kontratës:** 891.541,00 €
- **Data e fillimit:** 15/01/2008
- **Data e kompletimit:** 30/10/2010
- **Kontraktues:** KEMA (D)

### - Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur

Nga ana e stafit të konsulencës së angazhuar janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve instaluese, si dhe në aprovimin e dizajnit detal për LOT1 si dhe LOT2.

### - Menaxhimi i rreziqeve dhe pengesat:

Sipas konsulencës “KEMA”, Kontraktuesi nuk i ka realizuar punët implementuese sipas standardeve por është në përmirësim e sipër të tyre. Po ashtu sipas tyre parashihen vonesa në projekt për arsye:

1. Baza e të dhënave për testim “End to End”
2. Mosrealizimi i punimeve në KCS (Qendrën Nacionale Dispecerike) për shkak të mospagimit të hapësirës përkatëse nga KEK-u
3. Zbatimi i punimeve në pjesën veriore të Kosovës
4. Shkycjet e stabilimenteve 110 kV
5. Vonesa në realizimin e FAT-it për mbrojtjet rele dhe sistemin e komandimit për NS Prizreni 2

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Spektori: Planifikimi afatmesëm</i>

6. Vonesat për shkak të dështimit të FAT për RTU (tri herë)

## 8. Projekti SCADA/EMS & Telekom

### LOT 1 - SCADA/EMS

- **Buxheti i Siguruar:** 8.500.000,00 €
  - **Burimi i financimit:** BK
  - **Vlera e kontratës:** 7.875.370,00 €
  - **Data e fillimit:** 31/12/2008
  - **Data e kompletimit:** 30/10/2010
  - **Kontraktues:** Areva/Komtel (F/Ks)
- 
- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**  
 Projekti është në fazën e implementimit. Implementimi i punimeve të këtij LOT-i në EKCS (Qendrën Nacionale Dispecerike Emergjente) po vazhdon dhe janë duke u mbajtur takimet e rregullta javore si mbledhjet progresit mujor. Janë dërguar gjithsejtë 15 raporte inspektimi.  
 Duhet të vendoset dysHEMEJA Teknike në EKCS me qëllim të vazhimit të punimeve.
  - **Menaxhimi i rreziqeve dhe pengesat:**
    - o Mosrealizimi i punimeve në KCS (Qendrën Nacionale Dispecerike) për shkak të mossigurimit të hapësirës përkatëse nga KEK-u
    - o Zbatimi i punimeve në pjesën veriore të Kosovës
    - o Shkycjet e stabilimenteve 110 kV
    - o Vonesa në realizimin e FAT-it për mbrojtjet rele dhe sistemin e komandimit për NS Prizreni 2
    - o Vonesat për shkak të dështimit të FAT për RTU (tri herë)
  - **Rekomandimet:**
    - o Të lirohen lokalet nga KEK, ku do të bëhet instalimi i sistemit të SCADA/EMS
    - o Të zhvillohen aktivitete me instancat relevante për sigurimin e qasjes për kontraktuesin në NS Ujman dhe NS Vallaq, për zbatimin e punëve, konform kontratës
    - o Ekipi menaxhues i projektit do të insistojë në respektimin e kushteve të kontratës nga kontraktuesi. Asnjë dokument apo edhe dizajn nuk do të aprovohet pa respektimin strikt të këtyre procedurave; mosrespektimi i këtyre procedurave mund të qojë në vonesën e kompletimit të projektit dhe me këtë rast hyjnë në fuqi gjorbitjet, sipas kushteve të kontratës

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## LOT 2 – Telekom

- **Buxheti i Siguruar:** 9.500.000,00 €
- **Burimi i financimit:** BK
- **Vlera e kontratës:** 9,214.760,00 €
- **Data e fillimit:** 31/12/2008
- **Data e kompletimit:** 30/10/2010
- **Kontraktues:** Energoinvest/Areva (B&H/F)
  
- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**  
 Gjatë kësaj periudhe është vazhduar me komentimin/aprovimin e dizajneve detale për Sistemin e Telekomit nga konsulenca e angazhuar KEMA dhe ekipi menaxhuesi i projektit.  
 Po ashtu gjatë kësaj periudhe është bwrw Pranimi Teknik Inern nga ana e Komisionit tw KOSTT-it, për 19 linjat me OPGW të përfunduara. Si dhe janë realizuar SAT për OPGW në linjat: Prizren2 – Drenas, Gjakovë2 – Klinë, KosA – Prishtinë1  
 Kanë filluar punët në instalimin e OPGW në linjat:
  1. Kosova B – Besianë
  2. Prishtina 4 – Lypjan
  3. Kosova A – Vallaq
  4. Kosova A – Prishtina 3.
  5. Vallaq – Trepçë
  6. Burim – Vallaq
  7. Deçan – Peje 2
  
- **Menaxhimi i rreziqeve dhe pengesat:**
  - o Zbatimi i plotë i punimeve në pjesën veriore të Kosovës
  - o Shkyçjet e linjave 220 dhe 110 kV
  - o Pengesat ne instalimin e OPGW ne linkun TS Prishtina 3 – TS Prishtina 2 ende nuk janë eliminuar edhe përkundër angazhimit tonw dhe Policisw sw Kosovws
  - o Pengesa ne instalimin e shtyllës mbështetëse nr. 31 ne linjën Kosova A – Vallaq nga ana e pronareve të tokës ende nuk është eliminuar.
  
- **Rekomandimet:**
  - o Të zhvillohen aktivitete me instancat relevante për sigurimin e qasjes për kontraktuesin në NS Ujman dhe NS Vallaq, për zbatimin e punëve, konform kontratës
  - o Ekipi menaxhues i projektit do të insistoj në respektimin e kushteve të kontratës nga kontraktuesi. Asnjë dokument apo edhe dizajn nuk do të aprovohet pa respektimin strikt të këtyre procedurave; mosrespektimi i

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

këtyre procedurave mund të qojë në vonesën e kompletimit të projektit dhe me këtë rast hyjnë në fuqi gjobitjet, sipas kushteve të kontratës.

## 9. Projekti: Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Trafos 150MVA (LOT1) dhe Pajisjeve të Tensionit të lartë në NS. 220/110 kV Prishtina 4 (LOT2)

### *LOT 1 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i ATR3 150 MVA në NS 220/110 kV Prishtina 4*

- **Buxheti i Siguruar:** 3.500.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KOSTT
- **Vlera e kontratës:** 2.214.154,00 €
- **Data e fillimit:** 16/06/2009
- **Data e kompletimit:** 15/04/2010
- **Kontraktues:** Electroputere/Balkanpetrol (Ro/Ks)
  
- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**  
Projekti është energjizuar më 09.08.2010. Certifikata për Pranim të Përkohshëm është lëshuar më 30.08.2010 dhe si rrjedhojë afati garantues është deri më 29.08.2011.
- **Rekomandimet:**  
Ekipi menaxhues i projektit do të insistoj në respektimin e kushteve të kontratës nga kontraktuesi. Asnjë dokument apo edhe dizajn nuk do të aprovohet pa respektimin strikt të këtyre procedurave; mosrespektimi i këtyre procedurave mund të qojë në vonesën e kompletimit të projektit dhe me këtë rast hyjnë në fuqi gjobitjet, sipas kushteve të kontratës

### *LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajisjeve të Tensionit të lartë për ATR3 150 MVA në NS 220/110 kV Prishtina 4*

- **Buxheti i Siguruar:** 800.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KOSTT
- **Vlera e kontratës:** 775,202.37 €
- **Data e fillimit:** 24/07/2009
- **Data e kompletimit:** 23/02/2010
- **Kontraktues:** Siemens (At)
  
- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**  
Punimet kanë përfunduar, projekti është energjizuar më 09.08.2010. Certifikata e Pranimit të përkohshëm është lëshuar dhe afati i garancionit është deri më 30.08.2011. Kontraktuesit i është dhënë afat që të bëjë eliminimin e vërejtjeve të komisionit për pranim teknik intern.



	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

- **Menaxhimi i rreziqeve dhe pengesat:**

-

- **Rekomandimet:**

Ekipi menaxhues i projektit do të insistoj në respektimin e kushteve të kontratës nga kontraktuesi. Asnjë dokument apo edhe dizajn nuk do të aprovohet pa respektimin strikt të këtyre procedurave; mosrespektimi i këtyre procedurave mund të qojë në vonesën e kompletimit të projektit dhe me këtë rast hyjnë në fuqi gjobitjet, sipas kushteve të kontratës

**12. Projekti i Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)**

- **Buxheti i Siguruar:** 13.000.000,00 €
- **Burimi i financimit:** KE/ECLO
- **Vlera e kontratës:** -
- **Data e fillimit:** -
- **Data e kompletimit:** -
- **Kontraktues:** -

- **Përmbledhje e shkurtër e progresit të arritur:**

Projekti është shumë afër të përfundimit të fazës së tenderimit (të dy LOT-at). Pritet Nënshkrimi i Kontratës gjatë muajit Nëntor.


**13. Projekti i ndërtimit të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri në gjatësi prej 89,35 km(deri në kufi)**

- **Buxheti i siguruar:** 17.000.000,00 € kredi  
16.500.000,00 € grant  
500.000,00 € grant për

**konsulentë**

- **Burimi i financimit** KfWQeverija Gjermane
- **Vlera e kontratës** 366.639,00
- **Data e fillimit** 24.09.2009
- **Data e kompletimit:** 24.09. 2010 faza e parë
- **Kontraktues:** Intec Gopa/Gjermani

**Përmbledhje e shkurtër:** Projekti në aspektin kohor është duke përcjell dinamikën e planifikuar dhe vazhdimi i punëve përgatitore ka dal si rezultat i zgjerimit të projektit me nënprojektin për Kontroll të Frekuncës dhe Fuqisë në një regjim të përbashkët me Shqipërinë. Pritet që në gjysmën e Nëntorit 2010 të publikohet kërkesa për oferta sipas tenderit të përgatitur.

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

## 2.4. Çështjet Ligjore dhe Rregullative

### 2.4.1. Rishqyrtimi i vlerës së aseteve të KOSTT

Meqenëse sipas Metodologjisë për Tarifa të energjisë elektrike, për financimin e projekteve kapitale KOSTT-it i lejohet kthimi i lejuar për bazën rregulluar të aseteve dhe amortizimi, gjë që KOSTT-it i shkakton vështirësi për shkak të nivelit të ulët të bazës së rregulluar të aseteve<sup>2</sup>.

Prandaj, në fund të vitit 2009, KOSTT ka filluar të bëjë analizë lidhur me financimin e aseteve në vitet e ardhme dhe këtë çështje e ka ngritur në nivel të bisedës me ZRrE-në ku është diskutuar për problemet që janë identifikuar për financimin e projekteve sipas Planit Zhvillimor të Transmisionit 2010-2019.

Gjate vitit 2010, KOSTT në bashkëpunim me konsulentet ka vazhduar të bëjë analizë për mundësinë e zgjidhjes së problemit të financimit të projekteve kapitale, që reflektohet nga baza e ulët e aseteve. Në periudhën korrik – gusht është përgatitur dokumenti “Rishqyrtimi i vlerës së aseteve të KOSTT”, i cili paraqet rezultatet e këtyre analizave. Propozimet së bashku me konkluzionet përkatëse janë dërguar në ZRrE me datë 24 gusht 2010.

### 2.4.2. Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010- 2019

Me Vendimin V\_293\_2010, të lëshuar nga ZRrE të datës 10 shtator 2010, KOSTT është njohtuar se ZRrE ka aprovuar dokumentin: “**Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010-2019**”, të përgatitur nga KOSTT, i cili do të implementohet nga të gjitha departamentet e KOSTT-it.

Plani Zhvillimor i Transmisionit paraqet dokumentin bazë për zhvillimin e rrjetit të transmisionit dhe interkoneksioneve me rrjetet fqinje të transmisionit, me qëllim që të garantohet siguria e furnizimit me energji elektrike. Ky dokument përpilohet në përputhje të plotë me “Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës”.

### 2.4.3. Monitorimi Intern i Kodeve Teknike


Në bazë të planeve operative të departamentit, Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative në objektivat e departamentit ka vendosur edhe monitorimin intern për implementimin e Kodeve Teknike dy herë në vit. Në bazë të këtij monitorimi i cili është realizuar në gjashtëmujorin e parë është përgatitur **Raporti për monitorim Intern**.

<sup>2</sup> Vlera e aseteve para 1 janar 2006 është vlerësuar zero

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

Qëllimi i monitorimit intern për implementimin e Kodeve Teknike, është identifikimi i obligimeve për përmbushjen e të cilave paraqiten vështirësi apo pengesa. Në bazë të konkluzioneve të nxjerra do të planifikohen hapat e duhur për përmbushje të këtyre obligimeve, varësisht nga natyra e problemit duke i konsideruar në kategori të ndryshme si:

- Kërkesa për financim
- Kërkesa për amandmim të dispozitave të caktuara,
- Kërkesa për derogim për afate të caktuara kohore. Kërkesa për derogim i drejtohet KQKO-se (Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale e pastaj nga kryesuesi i KQKO-se dërgohet në ZRrE)

		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 28 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

## 2.5. Shqyrtimi i performancës financiare -

### 2.51. Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES: 01.07.2010-30.09.2010


	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Janar-Shtator/2009	Janar-Shtator/2010	%
<b>ASETETE JO QARKULLUESE</b>	<b>75,847,444</b>	<b>75,780,527</b>	<b>75,731,504</b>	<b>77,512,364</b>	<b>77,942,191</b>	<b>79,756,023</b>	<b>80,604,944</b>	<b>80,950,352</b>	<b>80,771,477</b>	<b>58,373,877</b>	<b>80,771,477</b>	<b>138.37%</b>
Prona, Fabrika dhe Paisjet	62,309,405	62,061,408	61,661,868	61,255,831	61,546,954	61,175,687	60,746,334	60,500,544	64,272,204	35,380,453	64,272,204	181.66%
Investimet në vijim	13,538,039	13,719,120	14,069,637	16,256,533	16,395,238	18,580,337	19,858,610	20,449,808	16,499,273	22,993,424	16,499,273	71.76%
<b>ASETET QARKULLUESE</b>	<b>28,903,774</b>	<b>29,959,766</b>	<b>30,683,454</b>	<b>30,026,327</b>	<b>30,335,325</b>	<b>32,046,280</b>	<b>32,435,581</b>	<b>32,981,561</b>	<b>33,500,965</b>	<b>29,678,406</b>	<b>33,500,965</b>	<b>112.88%</b>
Stoqet,Pjesët rezervë dhe veglat	926,748	995,107	884,084	837,085	803,629	746,007	725,008	720,816	684,333	1,009,766	684,333	67.77%
Kërkesat	10,396,174	12,286,639	12,144,434	11,786,205	11,177,482	11,001,735	10,436,864	10,295,004	10,162,992	8,380,979	10,162,992	121.26%
Kredi,Avanse dhe Depozita	8,501,752	8,501,943	8,255,879	7,750,485	7,681,567	8,482,519	8,137,745	8,189,773	8,147,216	9,591,130	8,147,216	84.95%
Tatimi i Parapaguar					150,000	150,000	300,000	300,000	300,000	38,500	300,000	779.22%
Paraja dhe Bilanci Bankar	9,079,099	8,176,078	9,399,056	9,652,551	10,522,647	11,666,019	12,835,964	13,475,969	14,206,425	10,658,031	14,206,425	133.29%
<b>TOTALI I MJETEVE</b>	<b>104,751,218</b>	<b>105,740,293</b>	<b>106,414,958</b>	<b>107,538,691</b>	<b>108,277,517</b>	<b>111,802,303</b>	<b>113,040,524</b>	<b>113,931,913</b>	<b>114,272,442</b>	<b>88,052,283</b>	<b>114,272,442</b>	<b>129.78%</b>
<b>KAPITALI I AKSIONARËVE DHE REZERVAT</b>	<b>39,920,040</b>	<b>40,703,241</b>	<b>41,355,360</b>	<b>41,896,240</b>	<b>42,235,797</b>	<b>42,806,178</b>	<b>43,079,886</b>	<b>43,499,364</b>	<b>43,898,843</b>	<b>36,872,146</b>	<b>43,898,843</b>	<b>119.06%</b>
Kapitali Aksionar	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	100.00%
Kapitali i trashëguar	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	28,346,963	100.00%
Fitimi i mbajtur	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	10,784,880	3,853,087	10,784,880	279.90%
Fitimi paraprak		763,197	1,546,398	2,198,516	2,739,396	3,078,954	3,649,334	3,923,043	4,342,521	3,979,175	4,342,521	109.13%
Fitimi mujor	763,197	783,201	652,119	540,880	339,558	570,380	273,709	419,478	399,479	667,921	399,479	59.81%
<b>OBLIGIMET JO QARKULLUESE</b>	<b>57,103,591</b>	<b>57,175,643</b>	<b>57,239,324</b>	<b>57,221,339</b>	<b>58,177,483</b>	<b>60,473,261</b>	<b>61,336,763</b>	<b>61,719,310</b>	<b>62,192,648</b>	<b>45,813,170</b>	<b>62,192,648</b>	<b>135.75%</b>
Të hyrat e shtyera	57,103,591	57,175,643	57,239,324	57,221,339	58,177,483	60,473,261	61,336,763	61,719,310	62,192,648	45,813,170	62,192,648	135.75%
<b>OBLIGIMET QARKULLUESE</b>	<b>7,727,586</b>	<b>7,861,410</b>	<b>7,820,274</b>	<b>8,421,113</b>	<b>7,864,236</b>	<b>8,522,865</b>	<b>8,623,875</b>	<b>8,713,239</b>	<b>8,180,951</b>	<b>5,367,967</b>	<b>8,180,951</b>	<b>152.40%</b>
Obl.nga tregtia dhe obl.tjera	7,727,586	7,861,410	7,820,274	8,421,113	7,864,236	8,522,865	8,623,875	8,713,239	8,180,951	5,367,967	8,180,951	152.40%
<b>TOTAL BURIMET E MJETEVE</b>	<b>104,751,218</b>	<b>105,740,293</b>	<b>106,414,958</b>	<b>107,538,691</b>	<b>108,277,517</b>	<b>111,802,303</b>	<b>113,040,524</b>	<b>113,931,913</b>	<b>114,272,442</b>	<b>88,053,283</b>	<b>114,272,442</b>	<b>129.78%</b>

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES

01.07.2010/30.09.2010

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Janar-Shtator/2009	Janar-Shtator/2010	%
Të hyrat nga tarifa	1,913,394	1,796,817	1,855,201	1,494,512	1,491,313	1,524,975	1,313,981	1,428,336	1,481,032	13,385,613	14,299,561	106.83%
Të hyrat tjera	206,600	203,849	208,098	209,272	208,503	214,985	210,686	211,545	269,155	796,097	1,942,694	244.03%
<b>Të hyrat totale</b>	<b>2,119,994</b>	<b>2,000,667</b>	<b>2,063,300</b>	<b>1,703,784</b>	<b>1,699,816</b>	<b>1,739,960</b>	<b>1,524,667</b>	<b>1,639,881</b>	<b>1,750,187</b>	<b>14,181,710</b>	<b>16,242,255</b>	<b>114.53%</b>
Shpenzimet e personelit	176,758	188,366	198,282	196,246	254,136	206,038	207,650	204,818	208,002	1,536,179	1,840,295	119.80%
Shpenzimet e materialit	544	3,759	4,358	2,079	1,906	3,661	1,400	3,087	2,868	17,944	23,662	131.87%
Rregullimi sekondar	83,000	83,000	83,000	83,000	83,000	83,000	83,000	83,000	83,000	747,000	747,000	100.00%
Amortizimi	452,553	453,806	454,339	454,744	471,914	472,582	473,263	483,398	554,287	2,040,891	4,270,886	209.27%
Energjia, telefoni dhe uji	25,093	22,709	20,341	13,733	17,226	13,407	14,050	14,140	13,272	155,330	153,971	99.13%
Riparime dhe mirëmbajtje	100,388	13,140	138,335	51,611	61,567	77,713	20,888	23,712	89,378	670,044	576,733	86.07%
Derivate dhe lubrifikante	4,552	3,699	5,306	5,437	5,391	846	13,918	5,213	1,915	60,974	46,278	75.90%
Medicina, siguria dhe transporti	17,860	16,340	17,900	17,367	17,856	22,127	27,914	23,163	22,593	141,412	183,120	129.49%
Shpenzimet tjera operative	31,314	41,573	62,078	39,031	131,004	48,894	44,300	49,846	74,943	429,482	522,983	121.77%
Pagat me kontratë	5,094	16,726	33,112	4,678	8,712	8,446	4,153	8,697	4,041	38,152	93,661	245.50%
Humbjet në transmision	459,641	374,348	394,130	294,976	307,546	232,867	360,422	321,330	296,560	3,697,207	3,041,818	82.27%
<b>Shpenzimet totale</b>	<b>1,356,797</b>	<b>1,217,466</b>	<b>1,411,181</b>	<b>1,162,904</b>	<b>1,360,258</b>	<b>1,169,580</b>	<b>1,250,959</b>	<b>1,220,403</b>	<b>1,350,858</b>	<b>9,534,614</b>	<b>11,500,406</b>	<b>120.62%</b>
Fitimi para Tatimit	763,197	783,201	652,119	540,880	339,558	570,380	273,709	419,478	399,329	4,647,096	4,741,849	102.04%
Tatimi në fitim											-	
<b>Fitimi për periudhë</b>	<b>763,197</b>	<b>783,201</b>	<b>652,119</b>	<b>540,880</b>	<b>339,558</b>	<b>570,380</b>	<b>273,709</b>	<b>419,478</b>	<b>399,329</b>	<b>4,647,096</b>	<b>4,741,849</b>	<b>102.04%</b>

		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 30 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

## 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare


IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur performancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

Treguesit	I-IX 2009	I-IX 2010	Spjegimet
<b>T1. Fitimi operativ marginal</b> = Fitimi neto /gjithësejt të hyrat	0.33	0.29	Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese. Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.
<b>T2. Treguesi i qarkullimit</b> = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese	5.53	4.09	Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është <b>1.5</b> .
<b>T4. Mbulimi i shp.operative</b> = gjith.të hyrat/shpenzimet operative	1.49	1.41	Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara Treguesi duhet të jetë <b>më i madh ose = 1</b>
<b>T5. Mbulimi i të hyrave</b> = gjith.s.të hyrat/ shpenzimet e lejuara	1.07	1.26	Treguesi duhet të jetë <b>më i madh ose = 1</b>

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

<b>T6. Mbulimi i shp.të lejuara = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat</b>	<b>0.93</b>	<b>0.79</b>	Treguesi duhet të jetë <b>më i vogël se 1 ose = 1</b>
<b>T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara</b>	<b>3.58</b>	<b>3.26</b>	Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRRë-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 3.26 m €/GWh. Ky indikator tutje analizohet duke iu referuar treguesit <b>T14</b> , që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.9 €/GWh. Pra, shpenzimet e realizuara për njësi janë më të ulëta se ato të lejuarat. Kjo tregon një performance të mirë për KOSTT-in, me që në këtë ka ndikuar niveli i humbjeve më i ulët se humbjet e planifikuara për periudhën janar-shtator.
<b>T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara</b>	<b>3.62</b>	<b>3.43</b>	Paraqet të hyrat për njësi. Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike
<b>T14. Shpenzimet totale për njësi = shpenzimet totale/GWh e transmetuara</b>	<b>2.5</b>	<b>2.9</b>	Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike.

**Vërejtje:** Indikatorët T5 dhe T14, kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e lejuara bazuar në metodologjinë e tarifave. Për t'u caktuar caku real, duhet të mblidhen të dhënat mbi kostot historike.

		<b>DT-PB-002</b>
	ver. 1.0	faqe 32 nga 47
Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave		Sektori:

### 3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

Nr.	Lënda nr.	Pranë	Objekti i kontestit	Vlera e kontestit	Statusi	Statusi	
1	Lënda Penale nr. 230/03	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	n/a	Palët janë denuar me denime penale (burgim 3 muajsh), pritet ekzekutimi	Lënda me Ankesë, e dorzuar në GjQ-Pr.me dt.28.03/07. Rrefuzohet Ankesa me Aktgjykimin nr.157/07 te dt.22.04.2009.	Lënda kthehet ne kontest Civil. Përpilim i padisë pas vlerësimit të damit.
2	Lënda Civile nr. 2248/03	Gjykata Komunale në Prishtinë	dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës	92,000.00	Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës	Seanca e caktuar për dt.14.07..2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesë padinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Akgjykimi.	
3	Lënda Penale nr. 232/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	10,100.00	Seanca e rradhës është caktuar që të mbahet më 18.11.2008. Shtyhet, për dt.30.01.2009.	Shtyhet për 27.02/09,Shtyhet për dt.13.03;shtyhet për dt.31.03.09.-shtyhet për 05.05/09.Seanca e rradhës me: dt.14.08/09,11h.	Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer.



	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

4	Lënda penale nr.326/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	2,370.00	Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01;shtyhet 30.03.2009...	Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtur Aktgjykimi.-është pranuar, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009)	Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer.
5	Lënda Civile nr.85/05	Gjykata Komunale në Prishtinë	kompensim i dëmit	50,000.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008	Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009,	Mbahet seanca përfundimtare dt.10.02/09; Pritet Aktgjykimi.Verifikimi i fundit me dt.11.06.2009.Refuzohet Kërkesëpadija e Paditësit. Në favor të KOSTT-it. Lënda me Ankesë në GjQ.
6	Lënda penale nr.297/02	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje	200	Gjykata e shkallës së dytë	Aktgjykimi është marrë, aprovohet Ankesa e KOSTT-it.Ktheht Lënda në Kontest Civil, për realizimin e dëmit.	Kontesti civil ne Gjykatën Komunale në Ferizaj, Padija e dorëzuar me dt.26.06/09.
7	Lënda civile C1.nr.505/07	Gjykata Komunale në Prishtinë	pagesa e kamatës ligjore	nuk ka	Përfaqësuesi i KEK-ut, ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it.	Është caktuar seanca me dt.01.04.2009,shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010.	Aktgjykimi nuk është i formës së prerë
8	Lënda penale nr. 2406/ 06	Gjykata Komunale në Prishtinë	vjedhje	15,398.00	Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm	Nuk kemi njoftim ende për formën e prerë.	Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Paditurve, nga dt12.06, do t'i dorëzohet me polici
9	Lënda penale nr.320/06	Gjykata Komunale në Kaçanik	vjedhje e rëndë	9,120.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008	Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi	Aktgjykimi me Ankesë, në GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

10	Lënda penale 284/06	Gjykata Komunale në Lipjan	vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar	KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit)		.Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut.
11	Lënda civile nr.130/07	Gjykata Komunale në Kaçanik	Prerja e drujve	<b>8.914.00</b>	Gjykata e shkallës së parë ia aprovon kërkesëpadinë e palës Murteza Dermjanit, KOSTT-i ka ushtruar Ankesë	Aktgjykimi i GjQ.Pr, dt 25.03.2010. Pritet propozimi për Ekzekutim (PpE). Kundërshtim në afatin ligjor.	Rrefuzohet kundërshtimi në.E.162/10, parashtrohet Ankesa në Gykatën e shkallës së dytë.
12	Lënda civile nr. 409/06	Gjykata Komunale në Prishtinë	Lirimi i banesës	nuk ka	Seanca e rradhës nuk është mbajturur, pritet caktimi i seancës tjetër	Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10(ditë pushimi).	Seanca e rradhës nuk është caktuar ende.
13	Lënda civile nr. 32/08, me Aktvendim 217/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Prerja e malit dhe hapja e rrugës	<b>5,026.00</b>	Nga dt.22.05/09, Gjykata kërkon Përgjigje në Padi. Është dërgu përgjigja.U mbajt seanca me dt.23.06/09.Gjykata propozon marrëveshje interne mes palëve.	Seanca e rradhës me dt.24.09/09, 12h. Para seancës palët ndërgjygjëse tentojnë sërish arritje të Marreveshjes.Dalje në vend me Gjykatën, dt.30.07/09. Gjykimi është kryer, presim Aktvendim.	Lënda me Ankesë në GjQ-Pejë
14	Lënda civile nr. 526/08	Lirimi i lokaleve në Kastriot	lirimi i lokaleve në Kastriot	nuk ka	Pritet caktimi i seancës kryesore		Ende nuk kemi njoftim për seancën e rradhës
15	Lënda civile nr.511/00	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokaleve në Kurriz	nuk ka	Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT- in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë	Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim.	Ende nuk është kryer.(Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda me Ankesë GjQPr.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

16	Lënda civile nr. 2168/04	Gjykata Komunale në Prishtinë	lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz	nuk ka	Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008	Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit.	Seanca e rradhës me dt.17.04/09,(Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata
17	Lënda civile C.nr.588/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Kompenzim dëmi	1719.04	Seanca u caktua për dt.19.01.2009	Seanca e rradhës në afat të pacaktuar	KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.
18	Lëndë civile, Padi	Gjykata Komunale Prizren	Kompenzim dëmi		I parashtruar me dt.11.03/09.	Pritet caktimi i seancës.	
19	Lëndë Civile C.nr.442/09	Gjykata Komunale-Prizren	Pengim posedi	500	Seanca e caktuar për dt.22.10/09 shtyhet,	Verifikimi i gjendjes faktike në terren, dt.04.11/09	Seanca mbahet dt.11.11/09,11,30h; shtyhet (nuk ka njoftim për seancën e rradhës)
20	Lënda C.nr.625/03	Gjykata Komunale Prishtinë	Eksproprijim		Seanca e dt.18.02.2010	Shtyhet për dt.22.02.2010, 10h	Legjitimiteti pasiv- I takon KEK-ut,(deklarata në procesin e seancës të dt.22.02.)
21	Lëndë civile , Padi	Gjykata Komunale Ferizaj	kompenzimi i dëmit	200,00€	Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09	Pritet caktimi i seancës.	
22	C.nr.2331/06	Gjykata Komunale Prishtinë	Kontratë Banesore	n/a	Seanca 18.05.2010	Duhet konstatuar legjitimiteti i të paditurës.	Nuk ka njoftim për seancën e rradhës.
23	G.nr.221/09	Gjykata Komunale - Kaçanik	kompenzimi i dëmit		Përgjigja në Padi, paraqitur në afat ligjor	Senaca e parë, dt.29.06.2010, shtyhet për 08.07/10	Gjykata cakton dalje në vend për ekspertizë.Seanca kryesore dt.08.10/10;Pritet Aktgjykimi.
24	C.nr.1559/06	Gjykata Komunale Prishtinë	pagesa e Rentës.		KEK ka paguar - Qershor/2006.	Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10	KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv.


	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

25	C.nr. 270/07	Gjykata Komunale Podujevë	Kompenzim dami	100.000,€	KOSTT- I padituri III-të (Tretë)	seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorzimi i shkresave të lëndës KOSTT-it	Seanca e rradhës sipas ftesës.
26	A.nr.888/10	Gjykata Supreme e Kosovës	Vlerësimi për TP	14.000,€	Ankesa e KOSTT-it pjesërisht e aprovuar nga Bordi Komunal.	Ka parashtruar në afat ligjorë	

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

#### 4. Transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të tretë 2010

Lloji	Emri i prokurimit	KONTRAKTORËT	Vlera e kontratës	Realizimi deri 30.06.2010	Realizimi prej 01.07-30.09/2010	Fatura në pritje	Vlera e realizuar e kontratës	Vlera e përealizuar e kontratës	Kontrata
Furnizim	Ndërrimi i stabilimenteve të TL në NS "Kosova B" ana 400 kV	SIEMENS	1,275,285.00 €	- €	191,292.75 €	- €	191,292.75 €	1,083,992.25 €	nr.214 dt.25.06.2010
Shërbim	Mirëmbajtja e CAS-it	INOVATIVI	190,000.00 €	7,801.00 €	20,804.00 €	- €	28,605.50 €	161,394.50 €	nr.133 dt.15.04.2010
Shërbim	Regjistrimi i automjeteve te	SIGURIA	22,182.44 €		2,065.50 €	- €	2,065.50 €	20,116.94 €	nr.206 dt.08.06.2010
Furnizim	Furnizim me pajisje harduerike	INTERSOFT-A	17,951.00 €		17,951.00 €		17,951.00 €	- €	nr.179 dt.24.05.2010
Shërbim	Sigurimi shëndetësor i puntorëve të KOSTT sh.a.	SIGURIA	127,000.00 €	- €	17,132.49 €	- €	17,132.49 €	109,867.51 €	nr.180 dt.26.05.2010
Punë	Rindertimi i linjës 110 kV, nr.126/5	ELSA	165,416.00 €		24,812.40 €	- €	24,812.40 €	140,603.60 €	nr.258 dt.01.09.2010
Furnizim	Ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuesve në LP 126/2	UMEL-DALEKOVDMONTAZA	118,059.00 €		118,059.00 €		118,059.00 €	- €	nr.237 dt.19.07.2010
Furnizim	Furnizim me derivate të naftës	PETROL OTI SLOVENIJA	160,000.00 €		14,747.11 €	- €	14,747.11 €	145,252.89 €	nr.194 dt.01.06.2010
Punë	Renovimi i nivelit 1 dhe përgatitja e tij për implementimin SCADA-EMS	AL_TRADE	320,671.97 €		48,100.79 €		48,100.79 €	272,571.18 €	nr.227 dt.13.07.2010
	Humjet në transm.Sipas tarifave	KEK	5,589,384.00 €	967,427.00 €	1,156,116.21 €	1,060,956.88 €	2,123,543.21 €	3,465,840.79 €	tarifat e aprovuara
<b><u>Totali</u></b>			<b>7,985,949.41 €</b>	<b>975,228.00 €</b>	<b>1,611,081.25 €</b>	<b>1,060,956.88 €</b>	<b>2,586,309.75 €</b>	<b>5,399,639.66 €</b>	

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 38 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

## 5. Të arriturat, dështimet dhe sygjerimet

### Operatori i Transmisionit

Ndër të arriturat e Departamentit të Transmisionit në këtë tremujor të cilat vlenë të përmenden janë:

- Zhvillimi i aktiviteteve në mirëmbajtje sipas planifikimit
- Pjesëmarrja dhe kontributi i stafit tonë në testimet dhe lëshimin në punë të stabilimenteve të reja
- Si rezultat i kapitalizimit të këtyre projekteve kemi rritjen e sigurisë dhe kualitetit të furnizimit me energji në pjesën më të madhe të sistemit tonë
- Realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve

#### Dështimet

- Gjatë tremujorit të tretë nuk ka pasë asnjë dështim apo ndonjë avari, sanimi i të cilit do të ndikonte në furnizimin me energji elektrike.

### Operatori i Sistemit

#### Të arriturat:

1. Zvoglimi i kohës së mosfurnizimit me energji elektrike për 76.8 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009
2. Zvoglimi i ankesave të palëve të treta për mos kualitet të furnizimit për 71.43% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009
3. Zvoglimi i humbjeve në transmision në përqindje, ndaj rrjedhave të energjisë për 4,97 %

#### Dështimet:

1. Rritja e vlerës mesatare absolute të devijimeve ndaj interkoneksionit për 56,84 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

Një nga shkaqet kryesore është fakti se që nga Nëntori 2009 nuk kemi monitorim në kohën reale të devijimeve ndaj programit të vendosur, për shkak të mos kompletimit të kësaj pune nga ana e kontraktorëve AREVA dhe SIEMENS. Vlen të ceket se nuk ekziston asnjë mundësi që kjo gjendje të përmirësohet derisa nuk sjellen matjet korrekte nga të gjitha linjat interkonektive, pra edhe nga NS Peja 3. Poashtu, ndikim këtu ka patur edhe sjellja jokorrekte e KEK-ut rreth aplikimit të redukimeve të ngarkesës, veçmas në rastet e rënieve të njëjësive gjeneruese.

## Financat

### Të arriturat:

- Arritja e të gjitha objektivave të parapara për këtë periudhë, të konfirmuar edhe nga Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë
- Kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve të KOSTT dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.
- Arritjet drejt harmonizimit të Pasqyrave financiare sipas IFRS dhe kërkesave nga ZRRE ( në fazën përfundimtare – draft )

Nuk ka ndonjë dështim apo mospushtes.

## Burimet Njerëzore

Departamentit të BNJ në këtë tre mujor nuk ka pasur dështime, ndërkaq si sukses konsiderohen:

1. Certifikim me ISO 9001:2008 dhe
2. Aprovimi i Politikave të prezantuara në Bordin e Drejtorëve për aprovim

## Çështjet Ligjore dhe Rregullative

### Të arriturat:

- Dërgimi në afatin e paraparë i raporteve të rregullta dhe sipas kërkesave të ZRRE, MEM dhe MIE.
- Përgatitja e dokumentit **Rishqyrtimi i vlerës së aseteve të KOSTT** me shpjegimet e analizës së bërë dhe propozim për rivlerësim të aseteve, i cili është dërguar si dokument mbështetës për kërkesën e paraqitur në ZRRE.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

- Organizimi i tryezës së punës për prezantim të studimit të përgatitur nga KOSTT “Zgjerimi i Rrjetit Transmetues”, me datë 27 shtator 2010.

#### Dështimet:

- Marrëveshjet e Kyçjes për kyçjet ekzistuese – janë të përgatitura për nënshkrim që nga dhjetori 2009 por ende nuk janë nënshkruar me KEK sh.a. dhe N.H. Ibër Lepenci sh.a.  
Në mesin e muajit shtator KOSTT ka pranuar nga KEK disa komente, gjegjësisht pyetje për sqarime të dispozitave të Marrëveshjes për Kyçje. KOSTT ka përgatitur përgjigjet dhe propozimet për përmbajtjen e dispozitave. Procesi i komentimit është duke vazhduar me kërkesa të reja nga KEK.

### **Operatori i Tregut**

#### Të arriturat:

- Barazimi Përfundimtar dhe lëshimi i faturave të kryer pa vonesë dhe në përputhje me rregullat e tregut.
- Asnjë kontest nga palët në treg në Barazimin Përfundimtar.
- Kontribut në përpilimin e termave të referencës për Grupin Teknik të Modelit të Tregut (KEMM TWG) ku rolin udhëheqës do ta ketë KOSTT
- Propozimi i mekanizmit balancues që do të prezantohet në Grupin Teknik për Model të Tregut

#### Dështimet:

Gjatë këtij tremujori nuk ka pas ndonjë dështim që është i ndërlidhur me punën e Operatorit të Tregut.

### **Menaxhimi dhe Inxhinieria e Projekteve**

#### Të arriturat

Në aspektin e Investimeve Kapitale në janë zhvilluar në Sistemin Transmetues si arritje e veçantë për tremujorin e tretë (Q3) konsiderohet kompletimi i ndërtimit të objekteve dhe lëshimi në operim i tyre:

- a. Lëshimi nën tension dhe nën ngarkesë i autotransformatorit 150 MVA, në NS 220/110/10.5 kV – Prishtina 4



	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## Dështimet

- a. Nuk ka

## **Vështirësitë/Pengesat**

- a. Moszgjidhja e çështjes pronësore – juridike/eksproprijimi i tokës për shtyllën nr. 1, në Linjën LP 110 kV, NS 110/10(20) kV – Skenderaj, në kuadër të Paketit Projektit Peja 3 bashkë me linjat ndërlidhëse
- b. Mosrealizimi i punimeve në KCS (Qendrën Nacionale Dispecerike) për shkak të mossigurimit të hapësirës përkatëse nga KEK-u, në kuadër të Projektit SCADA/EMS
- c. Zbatimi i punimeve në pjesën veriore të Kosovës, për Projektin SCADA/EMS (LOT1)
- d. Shkyçjet e stabilimenteve 110 kV për zbatimin e Projektit SCADA/EMS

## **Zyra e Planifikimi Strategjik dhe Performancave**

### Të arriturat:


- Kryerja me kohë e Raportit për tremujorin e dytë për NJPMNP sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aprovimi nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT
- Përgatitja me kohë e raporteve interne për përcjelljen e realizimit të buxhetit sipas departamenteve/zyrave
- Përgatitja e Planit të Biznesit dhe Planit të Buxhetit për vitin 2011, sipas afateve të parapara me Procedurën e Planifikimit, Parashiqimit dhe Buxhetimit

Gjatë këtij tremujori nuk ka pasë dështime apo ndonjë mospuskses.

## **Zyra e Prokurimit**

Në këtë tremujor nuk ka pasë dështime, ndërsa nga sukseset e Zyrës së Prokurimit vlejné të përmenden:

- Të gjitha procedurat e prokurimit janë zhvilluar duke u bazuar në Planin e Prokurimit për vitin 2010
- Zhvillimi i aktiviteteve tjera sipas planifikimit
- Shfrytëzimi i mjeteve në mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të mundshme, të siguruara nga buxheti

		<b>DT-PB-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 47</i>
<i>Departamenti ; Zyra e planifikimit strategjik dhe performancave</i>		<i>Sektori:</i>

## Shtojca 1: Aktivitetet e posaçme

### Informatë rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

#### 1) Takimi me ENTSO-E

Me 20 shtator 2010 është mbajtur takimi me ENTSO-E rreth anëtarësimit të KOSTT në ENTSO-E. Takimi ka qenë mjaft konstruktiv dhe përfaqësuesit e ENTSO-E ka dhënë sinjale pozitive lidhur me përmbushjen e kritereve teknike për anëtarësim në ENTSO-E.

#### 2) Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike

Lidhur me çështjen e dizajnit të tregut të energjisë elektrike, Ministria e Energjisë dhe Minierave ka kërkuar nga KOSTT që të udhëheqë Grupin Teknik Punues për Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë. Lidhur me këtë KOSTT ka përgatitur Termet e Referencës të cilat janë miratuar nga MEM, si dhe programin e punës. Gjithashtu është vendosur që KOSTT të merr pjesë në Komitetin Ndërministror për projektin Kosova e Re dhe Privatizimin e Distribucionit të KEK.

#### 3) Çështja e aseteve 110kV

Këshilltarët e Transaksionit kanë mbështetur qëndrimin e KOSTT për mos-ndryshimin e kufirit teknik dhe komercial ndërmjet KOSTT dhe KEK. Për më tepër këshilltarët ndër të tjera kanë sugjeruar që të konsiderohet mundësia e kalimit të trafove 110kV në pronësi të KOSTT, e që ka mbetur të shqyrtohet tutje. Lidhur me të fundit, KE sugjeroi që në buxhet të parashikohet një kategori për rehabilitimin e këtyre aseteve.

#### 4) Audtimi i pasqyrave financiare

Auditori Gjeneral i Kosovës ka kërkuar nga KOSTT që të anulohet tenderin për auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare. Sidoqoftë gjithashtu theksoi rëndësinë e auditimit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, e së paku për nevojat e donatorëve dhe partnerëve afarist.

#### 5) Konferenca për investime SHBA – Kosovë

KOSTT do të merr pjesë në konferencën për investime SHBA – Kosovë e cila organizohet nga Ambasada e Republikës së Kosovës në SHBA, dhe do të mbahet me 27 tetor 2010 në New York.

#### 6) Certifikimi me ISO 9001

KOSTT ka marrë certifikatën për ISO 9001, Sistemi për Menaxhimin e Cilësisë, dhe theksoi se në këtë proces është bërë një punë e madhe në hartimin dhe formatizimin e dokumenteve dhe procedurave të brendshme.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

### 7) Ankesa e KOSTT në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë

Me 17 Shtator 2010 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë ka hapur procedurën formale të kontestit mbi ankesën e KOSTT kundër Republikës së Serbisë për shkelje nga e fundit të Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE). Tash pritet që të ndiqen procedurat dhe afatet e ankesës pas të cilave Sekretariati do të jep rekomandimin e vet Këshillit të Ministrave të TKE

### 8) Tryeza e punës për studimin për zgjerimin e rrjetit të transmisionit

Me 27 shtator 2010 është mbajtur një Tryezë Pune ku u prezantua Studimi për Zgjerimin e Rrjetit Transmetues të Republikës së Kosovës. Objektive kryesore e studimit “**Zgjerimi i Rrjetit Transmetues**” është ofrimi i udhëzimeve për modernizimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës.

## Raport i Sekretarit të Kompanisë

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010 në KOSTT janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për implementimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Ky Raport përfshinë vetëm aktivitetet lidhur me punën e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe komisione të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it.

### 1. Takim pune i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it

Tremujori Korrik – Shtator ka filluar me takimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve që është mbajtur në KOSTT me datën 1 korrik 2010 i cili ka shërbyer si takim konsultativ i punës dhe aktiviteteve që priten në periudhën e ardhshme.

### 2. Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve më 22. 07 2010

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 22.07. 2010 ka shqyrtuar dhe aprovuar “Politikën për shitjen me ankand të aseteve të luajtshme dhe materialeve të nxjerrura jashtë përdorimit.” Mbledhja e jashtëzakonshme është thirrur për shqyrtimin dhe miratimin e kësaj Politike para fillimit të sezonit të pushimeve verore, dhe më tej të procedohet me hapat tjerë, në mënyrë që depot e KOSTT-it të lirohen nga materialet e pa përdorshme para sezonit dimëror.

### 3. Mbledhja e Komisionit të Projekteve Kapitale

Me datën 04 Gusht 2010 është mbajtur Mbledhja e Komisionit të Projekteve Kapitale. Në këtë Mbledhje është shqyrtuar Raporti tremujor (Q2) 2010 në aspektin e projekteve kapitale. Është shqyrtuar dinamika e realizimit të projekteve kapitale dhe janë paraqitur

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

vështirësitë në implementim. Si rast konkret është përmendur edhe Projekti Peja 3 dhe në kuadër të tij, pengesat në Skenderaj në implementimin e projektit.

#### **4. Mbledhja e Komisionit të BtD për Linjen 400 kV Kosovë-Shqipëri**

Mbledhja e Komisionit për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri është mbajtur me datën 10 gusht 2010 ( e martë) në ora 10:00 në KOSTT.

Komisioni për Linjën 400 kV pas diskutimeve në fund ka nxjerr konkluzat se:

- Komisioni për Linjën 400 kV i rekomandon BtD ta shtyj përpara shpalljen e tenderit për projektin e Linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri.
- Menaxhmenti të ndikojë në MEF që të shpejtohet procesi i ratifikimit të Marrëveshjes për financim të Linjës 400 kV në Parlament.
- Për mbledhjen e ardhshme shërbimet të përgatisin informata rreth çështjeve të ngritura lidhur me projektin e linjës 400 kV.

#### **5. Mbledhja e Komisionit të Auditimit të KOSTT-it me dt. 24.08.2010**

Bazuar në Planin e Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2010, Komisioni i Auditimit i KOSTT-it ka mbajtur mbledhjen e rregullt me datën 24.08.2010 rreth politikave të KOSTT-it dhe shqyrtimin e Raportit tremujor Prill-Qershor 2010 dhe ka shqyrtuar:

- a) Procesverbalin nga mbledhja e kaluar e datës 13 Maj 2010 (i cili është aprovuar);
- b) Raportin Tremujor për periudhën Prill-Qershor 2010 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP), të cilin e ka rekomanduar për aprovim nga Bordi;
- c) Buxhetin e reviduar për vitin 2010 – të cilin e ka rekomandura për aprovim nga Bordi
- d) Draft Politikat: Politikat e IT, Politika mbi Menaxhimin e Objekteve, Politika mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare me plotësime dhe ndryshime dhe Politika e orientimit/njoftimit për punëtorët e rinjë. Pas shqyrtimit të dokumenteve të prezantuara, Komisioni i Auditimit i ka rekomanduar KOSTT-it që të gjitha të i dërgohen Bordit.

Auditori i Brendshëm ka informuar Komisionin e Auditimit për auditimet shtesë për Zyren e Prokurimit me kërkesë të BtD, për vitin 2008 dhe 2009.

Komisioni i Auditimit ka diskutuar mbi çështjen e Auditimit të jashtëm për Pasqyrat Financiare 2010 dhe ka sugjeruar që kjo çështje të inicohet siaps Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## 6. Mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it më 30.08. 2010

Me datën 30.08.2010 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka shqyrtuar dhe aprovuar :

- a) Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e BtD e datës 27 Maj 2010
- b) Procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit e datës 16 Qershor 2010
- c) Procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit e datës 22 Korrik 2010
- d) Raportin e Komisionit të Auditimit;
- e) Raportin Tremujor për periudhën Prill-Qershor 2010
- f) Buxhetin e reviduar për vitin 2010
- g) Bordi i ka vlerësuar dhe aprovuar të gjitha Politikat siç rekomandoi Komisioni i Auditimit:
  - Politikat e IT
  - Politika mbi Menaxhimin e Objekteve
  - Politika mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare me plotësime dhe ndryshime dhe
  - Politika e orientimit/njoftimit për punëtorët e rinjë.

## 7. Të ndryshme

### 7.1. Shkresa e dërguar NJPMNP me datën 19.09.2010

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it bazuar në nenin 15 të Ligjit për Ndërmarrje Publike i është drejtuar Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP (NJPMNP) me kërkesë që të zëvendësojë një anëtar të Bordit dhe të Komisionit të Auditimit, i cili ka ndërruar jetë. Njëkohësisht është kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të vepohet bazuar në kërkesën e Kryesuesit të Bordit i cili ka kërkuar ndryshim të pozitës së tij në anëtar Bordi për shkaqe shëndetësore.

### 7.2. Komisione të tjera të Bordit

Në tremujorin Korrik – Shtator 2010 Komisione të tjera që i ka themeleuar Bordi nuk kanë mbajtur mbledhjet e tyre pasi kjo gjë nuk ishte e nevojshme. Bordi ka konstatuar se projekti për Linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri po zhvillohet sipas planit të paraparë.

### 7.3. Dërgimi i materileve NJPMNP

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit dhe Komisionit të Auditimit, raportet tre-mujore si dhe të gjitha shkresat tjera dhe infomatat siç kërkohen sipas nenit 31,32 dhe 37 të Ligjit për NP, rregullisht i dërgohen NJPMNP sipas afateve ligjore.

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

## Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

ECLLO – ( nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EJL – Evropa Jug-Lindore

FAT- (Factory Acceptance Test) – Pranimi teknik në fabrikë

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC –Hidro Centrali

IFRS – (nga angl. International Financial Reporting Standards) – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KE – Komisioni Evropian

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komisioni Qeverisës për Kodet Operacionale

LP – Largpërçuesi

MEM – Ministria e Energjisë dhe Minierave

MIE – Ministria e Integriteteve Evropiane

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

	<b>RAPORTI TREMUJOR</b>	<b>DT-OS-008</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 47</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi afatmesëm</i>

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managment System)  
 -Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

TMT – Transformator Matës i Tensionit

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë